

VENDIM
Nr. 219, datë 20.12.2019

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO POWER PANARIT” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALI
“VILE” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1994 kW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”; si dhe nenit 15, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 119/1 prot., datë 17.12.2019, të Drejtorisë së Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me “Licencimin e shoqërisë ‘Hydro Power Panarit’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali ‘Vile’ me kapacitet të instaluar 1994 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 157, datë 29.10.2019, “Filloi procedurën për licencimin e shoqërisë ‘Hydro Power Panarit’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i ‘Vile’ me kapacitet të instaluar 1994 kW, për një afat 30-vjeçar”.

- ERE, me shkresën nr. 32/44 prot., datë 31.10.2019, ka bërë publikimin në median e shkruar për “Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i ‘Vile’” dhe ka ftuar palët të bëjnë komente dhe sugjerime.

- ERE, me shkresën me nr. 587/1 prot., datë 4.11.2019, ka njoftuar shoqërinë lidhur me vendimmarrjen e Bordit, për “Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë ‘Hydro Power Panarit’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i ‘Vile’, si dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar”.

- ERE me shkresat nr. 587/2 prot., datë 20.11.2019, nr. 587/4 prot., datë 11.12.2019, ka rikujtuar subjektin për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Shoqëria “Hydro Power Panarit” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 587/3/4 prot., datë 27.11.2019, ka depozituar dokumentacionin e munguar.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 29.10.2015, është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sh.p.k., konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L52229023C.

- Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti, ndër të tjera, është edhe: “Ndërtimi, operimi, shpërndarja, shitja e energjisë elektrike të hidrocentralit mbi lumin Panarit. Prodhim dhe shitje energjie elektrike”.

- MIE, me miratimin përfundimtar nr. 2441/7 prot., datë 6.7.2017, ka miratuar ndërtimin e HEC-it “Vile” me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujërat e rrjedhjes së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panaritit, degë e lumit Osum, të qarkut Korçë.

- MIE, pas miratimit përfundimtar, ka lidhur me shoqërinë “Hydro Power Panarit” sh.p.k., kontratën me nr. 1951 rep.; nr. 882/2 kol., datë 4.9.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Vile”, me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujërat e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panarit, degë e lumit Osum, qarku Korçë”.

- Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 49 vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj me të drejtë ripërsëritje.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit nr. 109, datë 29.6.2015, nuk rezultoi të këtë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Hydro Power Panarit” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Vile”.

- Aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Panarit” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë vijon:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, geramat: “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, geramat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, geramat: “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për HEC-in, (neni 9, pika 4.1.1; pika 4.1.2 ; pika 4.1.3, geramat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4, geramat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, geramat: “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Në kuptim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hydro Power Panarit” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Vile” me fuqi 1994 kW, për një afat 30-vjeçar.
 2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e ujit, të rinovuar, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit, në datën 11.5.2022.
 3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e mjedisit, të rinovuar, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit, në datën 3.8.2020.
 4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.
- Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti